

AKT I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË

“FDR” SHPK

Sot, më 26.08.2020, unë i nënshkruari Bujar Xhaferaj, shtetas shqiptar, lindur më 8.05.1955, në Lushnjë, mbajtës i pasaportës shqiptare me nr. personal F50508038M, në cilësinë e ortakut të vetëm, me anë të këtij akti, themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe këtë akt.

Neni 1

Emërtimi

Shoqëria emërtohet “**FDR**” SH.P.K. (në vijim referuar si “**Shoqëria**”).

Neni 2

Forma juridike

Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në veçanti me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe në përputhje me këtë akt.

Neni 3

Selia

3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën:

“Rruga e Kavajës, Nd. 126, H. 28, Ap. 24, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë”.

3.2 Ortaku i Vetëm mund të hapë dhe/ose mbyllë filiale, degë, agjenci dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

4.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar shqiptar.



- 4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohen me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e këtij akti dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë

- 5.1 Objekti dhe fusha e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por nuk do të kufizohet në:
- 5.1.1 Tregti me shumicë e pakicë dhe import - eksport të pjesëve dhe pllaketave elektronike të të gjithë llojeve, mallrave industriale, pajisjeve elektrike dhe elektronike, kompjuterike;
 - 5.1.2 Blerje e shitje e materialeve që përdoren për kasat regjistruese, modemat e regjistrimit, терминаlet e transmetimi, të gjithë pjesët përbërëse përcjellëse të kasave regjistruese, distributorë të karburantit dhe gazit të lëngshëm, sistemet e automatizimit të pikave të karburantit;
 - 5.1.3 Montimi, prodhimi dhe riparimi i pjesëve të ndryshme elektronike, elektroteknike, elektromekanike dhe elektroshtepiake;
 - 5.1.4 Tregtim, riparim, furnizim me pjesë rezervë të të gjithë llojeve të instrumenteve matëse, ligjërishit të kontrolluara ose jo;

Neni 6

Kapitali Themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është ALL10,000.00 (dhjetë mijë) Lekë.
- 6.2 Kapitali themeltar i nënshkruar i Shoqërisë përbehet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale ALL10,000.00 (dhjetë mijë) Lekë.

Neni 7

Ortaku i Vetëm

- 7.1 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është Z. Bujar Xhaferaj, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnjë, më 8.05.1955, mbajtës i pasaportës shqiptare me nr. personal F50508038M, zotërues i 1 (një) kuote që i korrespondon 100% (njëqind për qind), të kapitalit themeltar në shumën prej ALL10,000.00 (dhjetë mijë) Lekë.

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet në çdo kohë, në një ose më shumë këste, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Ortakut të Vetëm.



8.2 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar, me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën ALL100.00 (njëqind Lekë), që është minimumi i vlerës së kërkuar nga ligji.

Neni 9

Transferimi i kuotës

Ortaku i Vetëm mund të vendosë në çdo kohë për transferimin e kuotës përmes shitjes, dhurimit, apo ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 10

Vendimmarrja

10.1 Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm.

10.2 Ortaku i Vetëm është përgjegjës, ndër të tjera, për vendime në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimi i politikave të biznesit të Shoqërisë;
- ndryshimi i statutit;
- emërimi dhe shkarkimi i administratorit/ëve, ekspertit/ëve kontabël dhe likuiduesve dhe shpërblimi i tyre;
- zmadhimi dhe/ose zvogëlimi i kapitalit;
- transferimi i kuotave;
- shpërndarja e fitimeve;
- riorganizimi dhe/ose likuidimi i Shoqërisë; dhe
- çdo çështje tjetër të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm dhe ky akt.

Neni 11

Regjistri i Vendimeve

11.1 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, vendimet e mëposhtme:

- miratimi i pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecursionit të veprimtarisë;
- shpërndarja e fitimeve dhe humbjeve;
- zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
- vendime në lidhje me investimet;

- riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë.

11.2 Lista e mësipërme nuk është shteruese dhe vendimet të cilat nuk regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve janë të pavlefshme.

Neni 12

Administrimi

12.1 Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratorë. Administratori i parë i Shoqërisë, deri më datë 26.08.2021, është:

- Rezmi Mirtaj, shtetas shqiptar, lindur më 16.04.1988, mbajtës i pasaportës shqiptare me nr. personal I80416061U;

12.2 Administratori/ët do të emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me një vendim të njëjtë.

12.3 Administratori/ët janë persona fizik/ë, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve do të vendoset në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë afatin e përcaktuar në kuadrin rregullator përkatës. Pavarësisht këtij kufizimi, kohëzgjatja e mandatit mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Ortakut të Vetëm.

Neni 13

Kompetencat e Administratorit

13.1 Administratori është përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë me palët e treta, në përputhje me dispozitat e këtij akti dhe legjislacionin e zbatueshëm.

13.2 Kompetencat dhe detyrat e Administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:

- a) zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Ortakut të Vetëm;
- b) sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin dhe standartet e kontabilitetit nga Shoqëria;
- c) kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me administrimin e veprimtarisë së biznesit të Shoqërisë;
- d) sigurimin e mirëmbajtjes së rregullt të dokumenteve financiare dhe kontabël të Shoqërisë;
- e) përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
- f) kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, që kërkohen sipas legjislacionit në fuqi;
- g) kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligj dhe në këtë akt.

13.3 Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj dhe nga ky akt janë të rezervuara për Ortakun e Vetëm ose kufizohen nga ky akt apo legjislacioni i zbatueshëm.

Neni 14

Eksperti kontabël i autorizuar

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Ortaku i Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënave kontabël te Shoqërisë do t'u besohet një ose me shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.

Neni 15

Viti ushtrimor dhe pasqyrat financiare

15.1 Viti ushtrimor fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

15.2 Viti i parë ushtrimor fillon datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mbaron më 31 Dhjetor 2020.

15.3 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar, nëse ka një të tillë, miratohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe depozitohen në organet tatimore brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

Neni 16

Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë

16.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me procedurën e likuidimit të saj.

16.2 Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar tagrat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

16.3 Administratori i Shoqërisë i njofton për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit, të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre për të përfaqësuar Shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse.

16.4 Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi. Gjatë kësaj procedure, togfjalëshi "në likuidim e sipër" duhet të vihet pas emrit të Shoqërisë.



Neni 17

Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 17.1 Ky akt bazohet në legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij, do të kryhen në përputhje me legjislacionin shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë akt do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
- 17.2 Në rast mosmarrëveshjes ose konfliktesh që mund të lindin nga ose në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij dokumenti, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e çdo pretendimi ose mosmarrëveshje.

Ky akt përpilohet ne 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM

BUJAR XHAFERAJ

